



Permbledhje joteknike e aktiviteve per Leje Mjedisore



“Prodhimi i mobilieve 11.1 Prodhim i mobilieve, n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.”

“Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve. 7.12 I. Veprimtaritë e lyerjes/veshjes të aplikuara në sipërfaqe druri.”

Subjekti: “T L M BALI” Sh.p.k

Hartoi: “EKO-STUDIO-PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Enna MADANI



Tirane, 2026



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje**
- ✚ Baza ligjore**
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit**
- ✚ Objektivat dhe qellimi**

- 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
- 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
- 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
- 4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
- 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktojne probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

• **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim teakteveligjoredhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisore te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A, B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*




1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti “T L M BALI” Sh.p.k me administrator Z. Tahir Bali eshte regjistruar prane QKR me NIPT L33715402S. Subjekti kërkon te ushtroje aktivitetin **“Prodhim i mobilieve, n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë”** dhe **“Veprimtaritë e lyerjes/veshjes të aplikuar në sipërfaqe druri”**, ne vendndodhjen Bashkia Lushnje, Rruga Krutje e Poshtme, Zona Kadastrale Nr. 2286, Nr i Pasurise: 68/22-Nd, Siperfaqja Totale 1827m².

Gjurma e Subjektit



1/6/2026, 1:14:20 PM



Nr.	X	Y
1.	472805.94	4528046.68
Sip. Totale (m ²)		1827 m ²



➤ Procesi teknologjik

Aktiviteti kryesor i subjektit “TLM Bali” përqendrohet në përpunimin, prodhimin dhe përfundimin e produkteve të mobilies dhe elementeve të ndryshme prej druri, duke kombinuar teknologji mekanike bashkëkohore me procese gjysmë-automatike. Veprimtaria zhvillohet mbi bazën e një linje prodhimi të organizuar dhe të koordinuar, ku çdo fazë lidhet drejtpërdrejt me fazën pasardhëse, me qëllim garantimin e cilësisë, saktësisë teknike dhe efikasitetit në prodhim. Funksionimi normal i kësaj linje kërkon bashkërendim të vazhdueshëm mes sektorëve, duke siguruar që lënda e parë të transformohet gradualisht dhe në mënyrë të kontrolluar në produkte të gatshme për treg.

Procesi i prodhimit nis me furnizimin me lëndë të parë, e cila përfshin dru masiv, MDF, melaminë, kompensatë, si dhe materiale ndihmëse si bojëra, llakë, sfungjer, copa tekstili, fibra dhe elemente të tjera të nevojshme për përfundimin e mobilieve. Këto materiale hyjnë në fabrikë në gjendje të përshtatshme për përpunim dhe i nënshtrohen një serie operacionesh teknike, duke kaluar nëpër sektorë të ndryshëm deri në përfundimin e produktit final.

Faza e parë e ciklit të prodhimit realizohet në sektorin e prerjes, ku lënda e parë përpunohet sipas dimensioneve dhe specifikimeve të përcaktuara në projektet teknike. Në këtë sektor kryhen prerje të sakta të paneleve prej MDF-je, melamine dhe kompensate, si dhe prerje të drurit masiv për forma të veçanta apo elemente konstruktive. Procesi zhvillohet në ambiente të pajisura me sistem aspirimi të centralizuar, i cili largon pluhurat dhe mbetjet e drurit, duke garantuar kushte të sigurta pune dhe mbrojtje të mjedisit të brendshëm.



Pas prerjes, materialet kalojnë në sektorin e përpunimit mekanik, ku realizohet formësimi i detaleve dhe përgatitja e tyre teknike për fazat e mëtejshme. Në këtë fazë kryhen operacione si profilimi i skajeve, hapja e kanaleve funksionale, shpimet teknike dhe përpunime të tjera precize. Përdorimi i makinerive CNC dhe pajisjeve të automatizuara siguron saktësi të lartë, përsëritshmëri të proceseve dhe përputhje të plotë me kërkesat e projektimit, duke minimizuar gabimet dhe humbjet materiale.



Në vijim, panelet dhe elementet e përpunuara kalojnë në sektorin e ngjitjes dhe përfundimit të skajeve, ku realizohet aplikimi i shiritave mbrojtës dhe estetikë në brinjët e paneleve. Ky proces përfshin ngjitjen e materialeve si PVC, ABS, melaminë apo veneer, duke përdorur ngjitës industrialë të posaçëm. Përmes një sërë operacionesh të kontrolluara, sigurohet një përfundim cilësor i skajeve, i cili përmirëson pamjen estetike të produktit dhe rrit qëndrueshmërinë e tij në përdorim.

Më tej, elementet e mobilie kalojnë në sektorin e shpimeve dhe përgatitjes për montim, ku kryhen shpime teknike për lidhje, hapje për mentesha, mekanizma funksionalë dhe aksesore të ndryshëm. Ky sektor luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e përputhjes së saktë të pjesëve gjatë montimit final, duke garantuar funksionalitetin dhe stabilitetin e produktit të përfunduar.

Një pjesë e produkteve i nënshtrohet procesit të lyerjes dhe tharjes, i cili realizohet në ambiente të veçanta dhe të izoluar. Në këtë fazë, sipërfaqet përgatiten përmes levigimit, më pas lyhen me bojëra dhe llakë të specializuar, duke përdorur pajisje profesionale me pistoletë. Prosesi përfundon me tharjen në dhoma të dedikuara, të pajisura me sisteme ventilimi dhe filtrimi, të cilat sigurojnë largimin e avujve dhe ruajtjen e cilësisë së ajrit.

Për prodhimin e mobilie të tapicuar, materiali kalon në sektorin e qepjes dhe montimit, ku përpunohen sfungjeri, copat tekstile dhe materialet mbushëse. Në këtë sektor realizohet prerja, qepja dhe montimi i elementeve të tapicerisë, duke përdorur makina qepëse industriale dhe pajisje të specializuara, me qëllim krijimin e produkteve komode dhe estetike të përfunduara.

Në fazën përfundimtare, produktet e gatshme kalojnë në sektorin e magazinimit dhe paketimit. Këtu kryhet kontrolli final i cilësisë, paketimi sipas standardeve përkatëse dhe



magazinimi i produkteve në kushte të përshtatshme deri në momentin e shpërndarjes. Ky sektor siguron që produktet të jenë të mbrojtura gjatë transportit dhe të dorëzohen tek klientët në gjendje të përsosur, duke përmbyllur në mënyrë të plotë ciklin e prodhimit të subjektit “TLM Bali”.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

• Pozita Gjeografike

Bashkia Lushnje bën pjesë në qarkun Fier dhe ka si qendër të saj qytetin e Lushnjes. Ajo kufizohet në veri me Bashkinë e Rrogozhinës, në verilindje me bashkinë e Peqinit, në lindje me bashkinë e Belshit, në juglindje me Bashkinë Ura Vajgurore, në jug me bashkinë e Roskovecit, në jugperëndim me bashkinë e Fierit dhe në perëndim me bashkinë e Divjakës. Bashkia ka një sipërfaqe prej 372.72 km² dhe ka në përbërje të saj 11 njësi administrative, të cilat janë: Lushnje, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballakat, Fier-Shegan, Kolonjë dhe Krutje. Bashkia Lushnje ka një popullsi prej 84,921 banorë.

Nga pikëpamja e infrastrukturave rrugore të sotme, bashkia Lushnje vazhdon të mbajë një pozicion mjaft të favorshëm gjeografik dhe strategjik si për shkak të pozicionimit ndërmjet dy pikave më të rëndësishme portuale (Vlora dhe Durrësi), ashtu edhe për arsye se në këtë territor kalojnë Korridori VIII dhe Korridori i Kaltër, të cilët, së bashku me Korridorin Durrës-Nish, përbëjnë korridoret më të rëndësishme të Shqipërisë.

Me infrastrukturën ekzistuese qyteti i Lushnjes ka këto distanca nga pika kryesore në Shqipëri:

- 80 km nga aeroporti i Rinasit,
- 83 km nga Tirana,
- 49 km nga porti i Durrësit,
- 29.3 km nga qyteti i Fierit,
- 66 km nga porti i Vlorës,
- 66 km nga qyteti i Elbasanit,
- 40.5 km nga qyteti i Beratit.

• Kushtet klimatike

Klima në këtë bashki, sipas klasifikimit Köppen-Geiger², i përket Csa³ dhe njihet në përgjithësi me termin klimë mesdhetare. Tiparet karakteristike të kësaj klime janë: dimër i butë me reshje dhe verë e ngrohtë e thatë. Prania e trupave ujorë në këtë bashki sjell edhe zbutjen e klimës gjatë verës, kur lagështia e ajrit mund të jetë më e lartë. Ky efekt është edhe më i dallueshëm në zonat urbane, ku prezenca e një trupi uhor (lumë, liqen etj.) mundëson krijimin e një mikroklime me temperatura më të ulëta në krahasim me pjesën tjetër urbane.

Bashkia Lushnje ka rreth 2,500- 2,700 orë diell në vit. Temperatura mesatare luhet nga 15-16°C. Në përgjithësi, nuk ka erëra me shpejtësi të madhe. Zona lindore e Bashkisë ka erëra me



shpejtësi 1.5-2.0 m/s, ndërsa pjesa perëndimore ka erëra më të shpejta të cilat arrijnë shpejtësinë 2.6-3.0m/s. Pjesa qendrore e Bashkisë ka erëra me shpejtësi 2.1- 2.5m/s 5. Reshjet janë të çrregullta në këtë bashki dhe variojnë mesatarisht nga 750-1,250 mm në vit.

- **Relievi**

Terreni i bashkisë Lushnje është kryesisht fushor, me kodra që shkojnë deri në 200 m lartësi mbi nivelin e detit në zonën verilindore dhe në zonën e Kolonjës. Zona fushore ka lëvizje të lartësisë nga 2.5 deri në 52 m mbi nivelin e detit dhe njihet për prodhimtarinë e madhe bujqësore. Kjo zonë bën pjesë në fushën e Myzeqesë dhe njihet për numrin e madh të serrave dhe rrjetin e pasur me kanale vaditëse. Fusha e Myzeqesë është ndër fushat më të mëdha në Republikën e Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë ka edhe prodhimtarinë më të madhe.

- **Hidrografia**

Territori i bashkisë Lushnje kufizohet nga rrjedhat e dy lumenjve kryesorë. Në veri të territorit kemi kalimin e lumit Shkumbin, ndërsa në juglindje, në kufirin me bashkitë Roskovec dhe Ura Vajgurore, kemi rrjedhën e lumit Seman. Përveç lumenjve kemi edhe disa rezervuare dhe liqene, si: rezervuari i Thanës, liqeni i Kasharajt, liqeni i Lushnjes. Ia vlen, gjithashtu, të përmendim edhe kanalet vaditëse, të cilat shtrihen përgjatë pjesës fushore. Ndër këto kanale mund të përmendim tri më të rëndësishmet, të cilat dalin nga rezervuari i Thanës: kanalin Emisar, kanalin përgjatë Semanit, si dhe kanalin që shkon drejt veriut përmes qytetit të Lushnjes. Për më tepër, në qytetin e Lushnjes kemi edhe rrjedhën e përroit të Lushnjes, i cili buron nga liqeni i Kasharajt. Ky përrore ka luajtur rol edhe si element i fortë i qytetit të Lushnjes, duke ndikuar në zhvillimin territorial të tij.

- **Cilesia e ajrit**

Të dhënat rreth cilësisë së ajrit në Qytetin e Lushnjes mungojnë. Megjithatë, për arsye të mësipërme, mendohet se të paktën në qytet, në afërsi të zonave me fluks trafik të lartë, cilësia e ajrit ndryshon (përkeqësohet) nga ajo e zonave rurale, ku cilësia e ajrit është e mirë. Edhe pse nuk njihet përmbajtja e gazrave ndotës në ajër, është e mundur të arrihet një vlerësim i përafërt i rreziqeve që i shkaktohen shëndetit të njeriut nëpërmjet ndotjes së ajrit nga disa sektorë, veçanërisht ai i transportit.

- **Biodiversiteti**

Bashkia Lushnje ndodhet në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 372.72 km². Relievi është kryesisht fushor me zona të kufizuara kodrinore të pozicionuara në verilindje të bashkisë në lartësi 200-240 mbi nivelin e detit. Sistemi natyror në Bashkinë Lushnje që shërben si habitat për biodiversitetin zë 1/10 e sipërfaqes totale të kësaj Bashkie. Sistemet natyrore shtrihen kryesisht në lindje, në pjesën kodrinore të saj. Bashkia ka një sipërfaqe pyjore në pronësi me rreth 822.62 ha, e cila shërben si habitat kryesor për biodiversitetin.



Në Bashkinë Lushnje, numri i specieve floristike dhe faunistike që rriten në territor nuk njihet. Megjithatë, njihet me përafërsi numri i specieve të rrezikuara. Sipas Librit të Kuq të florës së Shqipërisë, në territorin e Bashkisë gjenden 55 specie të rrezikuara dhe i përkasin kryesisht familjes së fluturave dhe shpendëve. Ndër to dallohen Asteri Shqiptar (*Aster Albanicus*) dhe Salepi Shqiptar (*Orchis Albanica*) që janë individë shumë të rrallë. Kryesisht, rreziku i humbjes së specieve vjen si rrjedhojë e aktiviteteve antropogjene, gjë që ka çuar në humbjen e habitateve.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për tu zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

- **Ndikimet në toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk ka aplikohen norma shkarkimi në toke, sic mund të jenë ndryshime në topografinë lokale, erozionin e tokës apo ndryshime të tjera të dukshme. Nuk do të ketë emetime kimike apo depozitime në tokë në vendin ku do të zhvillohet aktiviteti ose rreth zonës përreth pasi mjetet që do të transportojnë lëndet do të jenë të pastra dhe me kushte të rregullta teknike.

- **Ndikimet në cilesinë e ajrit**

Emetime në ajër nga funksionimi i këtij aktiviteti nuk do të jenë shqetësuese dhe në nivele të larta. Kryesisht do të kemi emetime vetëm nga mjetet e transportit të cilat janë në norma të ulëta sepse janë në kushte shumë të mira teknike.

- **Ndikimet në ujë**

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk shkaktohet ndotje e ujerave nëntokesore apo në ujrat sipërfaqësore. Duke iu referuar natyrës së aktivitetit nuk kemi shkarkime me karakter ndotes.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Duke qenë se aktiviteti ndodhet në largësi të konsiderueshme nga zonat e banuara dhe bizneset atëherë zhurmat nuk përbejnë shqetësim për komunitetin. Gjithashtu zhurmat që gjenerohen nga mjetet e transportit janë në nivele të ulëta sepse mjeteve i'u është bërë koalidimi dhe kontrolli i nevojshëm, ato janë në gjendje shumë të mira teknike. Zhurmat që do të gjenerohen nga procesi i punës, janë brenda normave të lejuara për mjedisë pune.



- **Mbetjet t prodhuara**

Mbetjet urbane do te grumbullohen ne kosha te vecante Brenda territorit te subjektit me pas do te depozitohen ne vendin e percaktuar nga NJ.Q.V. Sa i takon mbetjeve te tjera te gjeneruara nga aktiviteti ato do te trajtohet nga subjekte te licencuara me te cilet do te lidhen kontrata te posacme.

- **Ndikimet ne flore dhe ne faune**

Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi ndikime negative ne flore edhe faune. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk i prek as ne menyre te drejteperdrejte as ne menyre te terthorte.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Me qellim qe te parandalohen, shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

- **Masat për mbrojtjen e tokës**

Për të shmangur çdo ndikim të mundshëm në tokë, aktiviteti do të zhvillohet pa ndërhyrje në topografinë natyrore të zonës dhe pa kryer gjermime apo depozitime materiale në tokë. Nuk do të lejohen shkarkime apo derdhje aksidentale të lëndëve ndotëse, ndërsa mjetet e transportit dhe pajisjet e punës do të kontrollohen periodikisht për të parandaluar rrjedhje vajrash apo karburantesh. Në rast incidentesh të paparashikuara, do të merren masa të menjëhershme për pastrim dhe rehabilitim të sipërfaqes së prekur.

- **Masat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit**

Për ruajtjen e cilësisë së ajrit, do të përdoren vetëm mjete transporti dhe pajisje pune në gjendje të mirë teknike dhe të pajisura me certifikata të vlefshme kolaudimi. Aktiviteti do të organizohet në mënyrë që të minimizohet numri i lëvizjeve të mjeteve, duke reduktuar kështu emetimet në ajër. Gjithashtu, do të kryhen kontrole periodike teknike për të siguruar funksionim optimal dhe emetime brenda normave të lejuara ligjore.

- **Masat për mbrojtjen e ujërave**

Me qëllim mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, nuk do të kryhen shkarkime të ujërave të ndotura apo substancave me potencial ndotës. Aktiviteti do të zhvillohet duke respektuar plotësisht kushtet teknike dhe mjedisore, pa përdorim të lëndëve kimike të



rrezikshme. Çdo ujë i përdorur do të menaxhohet sipas kërkesave ligjore dhe do të shmangët infiltrimi i tij në tokë apo në trupat ujorë përreth.

- **Masat për reduktimin e zhurmave**

Për minimizimin e ndikimit nga zhurmat, aktiviteti do të zhvillohet në distancë të konsiderueshme nga zonat e banuara dhe subjektet e tjera ekonomike. Pajisjet dhe mjetet e punës do të jenë të mirëmbajtura dhe të kontrolluara rregullisht për të garantuar nivele të ulëta zhurme. Proceset e punës do të respektojnë normat e lejuara për mjediset e punës, ndërsa oraret e aktivitetit do të planifikohen në mënyrë që të mos shkaktojnë shqetësime për komunitetin përreth.

- **Masat për menaxhimin e mbetjeve**

Mbetjet urbane të gjeneruara gjatë aktivitetit do të grumbullohen në kosha të dedikuara dhe të mbyllur, brenda territorit të subjektit, dhe më pas do të dorëzohen për depozitim në vendet e përcaktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore. Mbetjet e tjera, përfshirë ato teknike apo të veçanta, do të menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe do t'u dorëzohen subjekteve të licencuara, me të cilat do të lidhen kontrata përkatëse për trajtim dhe asgjësim të sigurt.

- **Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës**

Duke qenë se aktiviteti nuk ndërhyr në zona natyrore të ndjeshme dhe nuk përfshin shpyllëzime apo ndryshime në habitatet ekzistuese, nuk parashikohen ndikime negative në florë dhe faunë. Megjithatë, aktiviteti do të zhvillohet duke respektuar parimet e mbrojtjes së biodiversitetit, duke shmangur çdo ndërhyrje të panevojshme në mjedisin natyror dhe duke siguruar që proceset e punës të mos cenojnë ekosistemet përreth.

- **Masat për Parandalimin e Zjarrit**

Masat për mbrojtjen kundër zjarrit janë parashikuar në projekt dhe janë si më poshtë:

- Largimin e materialeve të ndezshme nga ambientet e godines dhe vendosjen e tyre në vende të sigurta për parandalimin e transmetimit të zjarrit
- Mbajtje e lire e rrugëve të largimit
- Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshëm i instalimeve elektrike në përputhje me rregullat përkatëse për instalime të tilla.
- Pozicionimi i shenjave në vende të dukshme dhe vendosja e instruksioneve për veprimet që duhet të kryejë personeli në rast zjarri.
- Pozicionimi i shenjave që paraqesin pozicionet e shuaresve të zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjencës.



- Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuarese si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidratante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne projekt.

Detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësi vetë, duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:

- Te kualifikoje punonjesit, per teknologjine ne perdorim, proceset e punes dhe kerkesat teknike qe duhet te zbatohen.
- Te pranoje ne pune persona te afte nga ana shendetesore dhe mendore qe e verteton me raport mjeksor.
- Ti instruktoje punonjesit per proceset e punes qe do te kryejne.
- Ti njoh me rregulloret e sigurimit teknik ne fuqi.
- Ti njoh me rregulloren e mbrojtjes nga eksplozioni
- Ti njoh me rregulloren e mbrojtjes nga zjarri.
- Tju beje te ditur shkaqet e aksidenteve dhe masat qe duhet te merren per ti menjanuar ato.
- Te siguroje mjetet mbrojtese individuale dhe kolektive per punonjesit.
- Te monitoroje nivelin e sigurise ne pune.

Përveç sa më sipër punëdhënësi ka detyrë që:

- Të sigurojë për çdo rast ndihmen e parë mjekesore.
- Të vendos në territorin e instalimit, në vende të dukshme tabelat me rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.
- Të bëjë instuktimin periodik të punonjësve dhe të plotësoj për këtë qëllim formularët bazë të përcaktuar në rregulloret e sigurimit teknik.

Detyrimet e punëmarrësit

- Të njoh mirë procesin e punës dhe makinerite apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojtë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masash duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme per ndihmën e shpejtë.



Shoqëria ka për detyrë:

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e AKM, ISHMPU dhe Njesise Vendore për një rrezik te menjehershëm.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione:

- Aktiviteti i prodhimit të mobilieve zbatohet në përputhje me standardet e sigurimit teknik dhe higjienës në punë, duke minimizuar rreziqet për punonjësit dhe parandalimin e aksidenteve gjatë procesit të prodhimit.
- Mbetjet e prodhimit, përfshirë pluhurat e drurit, mbetjet nga llakët, bojrat dhe shiritat mbrojtës, menaxhohen dhe depozitohen në mënyrë të kontrolluar, duke reduktuar rrezikun e ndotjes së tokës dhe ajrit.
- Makineritë dhe pajisjet e përdorura në prodhim janë të mirëmbajtura dhe të pajisura me sisteme sigurie, për të shmangur aksidentet dhe dëmtimet teknike gjatë përdorimit.
- Subjekti ka planifikuar procedura të qarta për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve urbane dhe industriale, duke siguruar dorëzimin e tyre tek subjektet e licencuara për asgjësim të sigurt.

Rekomandime:

- Kontrolli periodik i makinerive dhe pajisjeve të prodhimit duhet të kryhet për të shmangur rrjedhjet e lëndëve ndotëse (p.sh. bojëra, llakë) dhe për të parandaluar zhurmat e panevojshme apo defektet teknike.
- Trajnimi i punonjësve mbi përdorimin e teknologjisë, sigurinë në punë dhe masat mjedisore duhet të realizohet rregullisht, duke përfshirë udhëzime për menaxhimin e mbetjeve dhe përdorimin e mjeteve mbrojtëse.
- Mbetjet e drurit dhe materialeve të tjera duhet të grumbullohen në zona të përcaktuara brenda fabrikës dhe të dërgohen tek operatorë të licencuar për trajtim ose riciklim, për të shmangur ndotjen e tokës dhe ajrit.
- Ambientet e punës, veçanërisht sektorët e prerjes dhe lyerjes, duhet të jenë të pajisura me sisteme aspirimi dhe ventilimi të mirëmbajtur rregullisht, për të garantuar cilësi të ajrit dhe largimin e pluhurit apo avujve kimikë.
- Kontrolli dhe mirëmbajtja e sistemeve elektrike dhe të instalimeve të pajisjeve të lyerjes/llakimit duhet të kryhet për të parandaluar rreziqe zjarri dhe incidente të tjera.
- Dokumentimi dhe raportimi i mbetjeve dhe ndotjeve të mundshme duhet të mbahet i rregullt, për të garantuar transparencë ndaj autoriteteve mjedisore dhe për të siguruar përputhshmërinë me ligjin për mbrojtjen e mjedisit.